



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 86/2 prot.,

Datë 16.01.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR  
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “NELSA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “*FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MËNCËN*”, me fond limit 2.791.328. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “NELSA” SHPK, me Nipt. J71601012S.  
*Adresa: Rr: Tiranë-Dajt, Lagjja Qesarakë Nr. Pasurie 199/32, Hyrja 1, Dajt, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë  
*Adresa: Rruga “Maliq Muço” Nr.19 ,Tiranë.*

Në datën 15.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 86/2024 prot. e operatorit ekonomik “NELSA” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “*FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MËNCËN*”, me fond limit 2.791.328. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “NELSA” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*  
*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, do të publikojë arsyet e skualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimes “NELSA” SHPK, kundërshton në ankesën e ardhur më datën 15.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me nr. 86/2024 Prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

*“Pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Nelsa, shpk, Rezulton se nuk është plotësuar pika 2.3 .5 Kapciteti Teknik sipas DST, 2.3.5-e DHE 2.3.5-f, Operatori ekonomik nuk ka provuar me deklaratë nga Administratori i Shoqërisë që Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara. Operatori ekonomik ka në mungesë dokumentacionin Leje Higjieno-Sanitare për automjetin, leshuar nga Drejtoria e Shëndetit Publik”.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 16.01.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**